



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUZILAČKI SAVET KOSOVA  
SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT  
ARKIVA - ARHIVA

25 -07- 2022

Nr./Br. 12441/2022

PRISHTINË - PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
AKADEMIA E DREJTËSISË  
ACADEMY OF JUSTICE

Nr. Prot. Org. Jodir. Org. Unit	/	Nr. Prot. No. Prot. No.	223
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	04	Data Datum Date	25.07.2022

Prishtinë / a

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet:

**Akademisë së Drejtësisë dhe Këshillit Prokurorial të  
Kosovës për (Zbatimin e Strategjisë për Sundimin e  
Ligjit 2021-2026)**

## **Neni 1 Palët**

- 1.1. **Akademia e Drejtësisë** (në vijim AD), përfaqësuar nga z. Enver Fejzullahu-Drejtor Ekzekutiv i Akademisë, dhe
- 1.2. **Këshilli Prokurorial i Kosovës** (në vijim KPK), përfaqësuar nga z. Jetish Maloku – Kryesues i Këshillit

## **Neni 2 Qëllimi i Memorandumit**

Qëllimi i këtij Memorandumi është vendosja e bashkëpunimit në mes Akademisë së Drejtësisë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës për bashkërendimin dhe koordinimin e aktiviteteve me qëllim të realizimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026 përmes të zbatimit të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit të kësaj strategjie në fushën e trajnimit.

## **Neni 3 Obligimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës**

- 3.1. Sekretariati i KPK-së siguron që vendimet me shkrim të KPK-së i dorëzohen me kohë AD-së.
- 3.2. Vendimet e KPK-së të përmbajnë rekomandime konkrete për fushat-detyrat e kategorisë si në nenin 5 të këtij memorandum.
- 3.3. KPK ndërmer veprime konkrete për realizimin e detyrave të kategoritë si në nenin 5 të këtij memorandum.
- 3.4. KPK ndërmer veprime koordinuese me AD-në për realizimin e detyrave si në kategoritë në nenin 5.
- 3.5. KPK së bashku me AD-në sigurohen që të kenë burime (psh. financat, ekspertiza për analizat,) në dispozicion për realizimin e detyrave si në kategoritë në nenin 5.
- 3.6. KPK dhe AD pajtohen për të përcaktuar standardet e koordinimit dhe ndërlidhjen e sistemeve elektronike për të mundësuar shkëmbimin e informatave në mes të KPK-së dhe AD-së si dhe për të garantuar mekanizmat e koordinimit në trajnimin e prokurorëve.

## **Neni 4 Obligimet e Akademisë së Drejtësisë**

- 4.1. Identifikon dhe vlerëson nevojat së bashku me KPK-në për fushat si në nenin 5.
- 4.2. Ndërmer veprime konkrete për realizimin e detyrave për kategoritë si në nenin 5.
- 4.3. Ndërmer veprime koordinuese me KPK-në për realizimin e detyrave si në kategorinë në nenin 5.
- 4.4. AD-ja së bashku me KPK-në sigurohen që të kenë burime (psh. financat, ekspertiza për analizat) në dispozicion për realizimin e detyrave të kategorisë si në nenin 5.
- 4.5. AD-ja siguron që trajnerët e caktuar për trajnimin kanë performancë të dëshmuar të suksesshme.

- 4.6. AD-së dhe KPK pajtohen për të përcaktuar standardet e koordinimit dhe ndërlidhjen e sistemeve elektronike për të mundësuar shkëmbimin e informatave (të dhënave) në mes të AD-së dhe KPK-së si dhe për të garantuar mekanizmat e koordinimit në trajnimin e prokurorëve.

## **Neni 5**

### **Fushat e bashkëpunimit dhe modalitete e zbatimit**

- 5.1. Ky Memorandum përfshin këto fusha vijuese të veprimit të cilat do të realizohen përmes bashkërendimit të aktiviteteve, si:
- 5.1.1. Identifikimi i nevojave trajnuese për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe për anëtarët e komisioneve për rekrutimin e prokurorëve.
  - 5.1.2. Përforcimi i mekanizmit për analizimin e vlerësimeve të performancës me qëllim të identifikimit të nevojave specifike për trajnim të prokurorëve.
  - 5.1.3. Në sferën e hartimit të programeve të trajnimit për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës dhe për anëtarët e komisioneve për rekrutimin e prokurorëve.
  - 5.1.4. Ofrimi i trajnimeve për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës dhe për anëtarët e komisioneve për rekrutimin e prokurorëve në zbatimin praktik të legjislacionit në fuqi.
- 5.2. Trajnime për Zyrën për mbikëqyrje, analitikë dhe verifikim me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në verifikim.
- 5.3. Trajnime që dalin si rezultat i vlerësimit të dobët të performancës së prokurorëve.
- 5.4. Realizimin e analizave për nevojën për specializim të prokurorëve.
- 5.5. Trajnime për përkthyes-interpretë të prokurorëve.
- 5.6. Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve në sistemin prokurorial i realizuar brenda 3 deri 5 vitet e fundit.
- 5.7. Përcaktimin dhe garantimin e standardeve të koordinimit dhe ndërlidhjen e sistemeve elektronike për të mundësuar shkëmbimin e informatave në mes të AD-së dhe KPK-së në trajnimin e prokurorëve.
- 5.8. Formimin e grupeve të ngushta të punues, përkatësisht ekspertëve në realizimin e detyrave të lartpërmendura për kategoritë e përmendura.
- 5.9. Mbështetjes profesionale, teknike dhe organizative në realizimin e detyrave të lartpërmendura për kategoritë e cekura më lartë.

## **Neni 6**

### **Kohëzgjatja e Memorandumit**

Memorandumi i bashkëpunimit vlen për periudhën sa zgjat zbatimi i Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026 dhe plani i Veprimit.

## **Neni 7**

### **Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

- 7.1 Ndryshimet dhe modifikimet e këtij Memorandumi mund të bëhen në çdo kohë sipas nevojave dhe pëlqimit të palëve nënshkruese në pajtim me Strategjinë e Sundimit të Ligjit 2021-2026.
- 7.2 Të dy institucionet do të emërojnë nga një pikë kontakti, përgjegjës për komunikim dhe koordinim të aktiviteteve të përbashkëta dhe ta informojnë njëra tjetrën në formë të shkruar.
- 7.3 Secila palë merr përgjegjësinë për të përmbushur detyrat dhe obligimet që burojnë nga ky Memorandum.
- 7.4 Mospajtimet ose interpretime eventuale të ndryshme të pikave të kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptimin e palëve, por jo në dëm apo shkelje të obligimeve që parasheh Strategjia e Sundimit të Ligjit 2021-2026.
- 7.5 Akademia e Drejtësisë dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, pajtohen mbi procedurën e nënshkrimit të protokolleve të nevojshme.

### **Neni 8** **Nënshkrimi i Memorandumit**

Ky Memorandum nënshkruhet në Prishtinë me datën 12.07.2022. Është përgatitur në dy (2) kopje identike për secilën palë në gjuhën shqipe dhe serbe.

### **Neni 9** **Hyrja në fuqi**

- 9.1 Ky Memorandum do të hyjë në ditën e nënshkrimit nga palët.
- 9.2 Ky Memorandum hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët.
- 9.3 Palët e shprehin pajtimin me këtë Memorandum përmes vendosjes së nënshkrimeve të tyre si më poshtë.

### **Palët nënshkruese**

**Këshilli Prokurorial i Kosovës**

Z. Jetish Maloku - Kryesues

The image shows a blue ink signature of Z. Jetish Maloku over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVËS' and 'Këshilli Prokurorial i Kosovës'.

**Akademia e Drejtësisë**

Z. Enver Fejzullahu - Drejtor Ekzekutiv

The image shows a blue ink signature of Z. Enver Fejzullahu over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVËS' and 'AKADEMIA E DREJTËSISË'.